



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA DRAGASH – OPŠTINA DRAGASH- MUNICIPALITY OF DRAGASH



DATE	14/ 09/ 2022
PER /ZA/TO	KFOR COMMAND- WEST Chief CIMIC OF-2 SCALON TOMMASO
NGA/OD/FROM	Kryetari i Komunës DRAGASH z.Bexhet XHELADINI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Kërkesa për furnizim me paisje për Njësinë e Zjarrfikësve të Komunës së Dragashit në vlerë prej 8,000.00 €

Të nderuar,

Komuna e Dragashit ka shumë vite që ka një bashkëpunim shumë të mirë me CIMIK-un, andaj vazhdimi i bashkëpunimit përmes realizimit të projekteve të përbashkëta është shumë i rëndësishëm për Komunën e Dragashit.

Siç e dini, një pjesë e madhe e territorit të Komunës së Dragashit është e mbuluar me pyll. Vitet e fundit ka pasur disa zjarre gjatë stinës së verës. Një nga zjarret më të mëdha ka ndodhur në vitin 2012 kur zjarri përfshiu pyllin me pisha në Koritnik. Rreth 70 hektarë pyll janë djegur. Pas kësaj, në vitin 2015 u dogjën edhe 5 hektarë të tjerë pyll me pisha. Pothuajse çdo vit, Komuna e Dragashit ballafaqohet me këto probleme.

Mekanizimi shumë i dobët që posedon Drejtoria Komunale për Situata Emergjente si dhe qasja e dobët në terren e pengojnë Drejtorinë për Emergjencë që në mënyrë efektive dhe të shpejtë të parandalojë përhapjen e zjarrit. Në disa raste, njësitet e KFOR-it me helikopterë kanë marrë pjesë në shuarjen e zjarrit.

Puntorët e shërbimit të Zjarrfikësve poashtu nuk janë të pajisur me paisje përcjellëse të cilat do t'i ndihmonin në përballjen me situatat emergjente të zjarrvënies.

Andaj, meqenëse Komuna e Dragashit nuk ka mjete të mjaftueshme për ta pajisur plotësisht këtë shërbim po ju shkruaj me shpresën se do të gjeni mundësinë të na siguronit pajisje (çantë ergonometrike, gyp për zjarrfikës, motorsharrë për prerjen e drunjëve, fshesa metalike për shuarjen e zjarrit, çantë-ventilator, kositëse, pompë uji lëvizëse) për Shërbimin e Zjarrfikësve në mënyrë që të ju lehtësohet shuarja e zjarreve në terrene të paaksesueshme.


Shpresoj se do t'i merrni parasysh arsyet e deklaruara dhe se do ta përkrahni këtë kërkesë, si dhe të vazhdoni me aktivitetet tuaja në Komunën e Dragashit.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

Bexhet Xheladini

Kryetar i Komunës së Dragashit



CD 104/02-15933/22
14.09.22

